

Data: 11 Janar 2012

“DEKLARATË PËR SHTYP – ANKETA MBI LIGJIN PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE”

Anketa mbi Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve u zhvillua nga IDRA Research & Consulting, me kërkesë të Aleancës Kundër Importit të Plehrave (AKIP) dhe financim të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Soros.

Qëllimet e kësaj ankete janë:

- a) të masë shkallën e njohjes nga ana e qytetarëve mbi ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve,
- b) të vlerësojë qëndrimin e qytetarëve në lidhje me organizimin e një referendumi të mundshëm, si dhe
- c) të vlerësojë qëndrimin e tyre në lidhje me importin e mbetjeve si çështje referendare

Anketa në fjalë është zhvilluar gjatë muajit Dhjetor 2011, më specifiku gjatë segmentit kohor 5 Dhjetor 2011 – 23 Dhjetor 2011.

Intervistat janë kryer me një kampion përfaqësues të **zonave urbane** të Shqipërisë. Madhësia e kampionit ka qënë N=600 të anketuar të moshës 18 vjeç e sipër.

1. GJETJET KRYESORE

- I. **Niveli i Informimit mbi Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve:** Të pyetur nëse kanë dëgjuar për Ligjin për Menaxhimin e Mbetjeve, **83.2% e të intervistuarve** kanë deklaruar “Po”, përgjigje e cila dëshmon një nivel të lartë të njohjes së kësaj çështjeje nga publiku i zonave urbane. Niveli i informimit mbi këtë ligj është i lartë përgjithësisht për të gjitha grupmoshat e intervistuar por me një tendencë rritjeje drejt moshave më të mëdha (76.5% e moshave 18-24 vjeç, rezidentë të zonave urbane janë në dijeni për këtë ligj; 88.9% e moshave 55 vjeç e sipër, rezidentë të zonave urbane janë në dijeni për këtë ligj). Niveli i njohjes është më i lartë në Tiranë (87,6%) por edhe zonat e tjera urbane shfaqin gjithashtu një nivel të lartë (81.5%).
- II. Pyetjes nëse ky ligj **lejon apo ndalon importin e mbetjeve**, rreth **70% e të intervistuarve të cilët janë në dijeni të ligjit deklaruan që ky ligj e lejon importin e mbetjeve**. Pjesa tjetër deklaroi ose “Nuk e di” (17%) ose “Ligji nuk e lejon importin e mbetjeve” (13%).
- III. Rreth **80% e popullsisë urbane** të Shqipërisë mendon se “**Importi i mbetjeve**” është një çështje e rëndësishme për vendin tonë. Në këtë opinion nuk ka ndryshime që rrjedhin nga vendbanimi, gjinia apo mosha.
- IV. Afërsisht **80% e të intervistuarve** u shprehën për **nevojën e organizimit të një referendumi kombëtar** për të vendosur mbi lejimin apo ndalimin e importit të mbetjeve. Edhe ky opinion nuk ka dallime statistikisht domethënëse nga mosha, gjinia apo vendbanimi.

- V. Nëse një referendum i tillë do të mbahej **78.4% e të intervistuarve** deklarojnë se do të votojnë **kundër lejimit të importit të mbetjeve** në Shqipëri, **9,2%** do të votojnë **pro lejimit të importit të mbetjeve**, 6,2% nuk janë të sigurt se si do të votojnë dhe **6,3% nuk do të votonin fare**. Faktorët demografikë (gjinia, mosha apo vendodhja urbane) nuk kanë ndonjë ndikim domethënës në votën e deklaruar të kësaj shumice kundër ligjit.

METODOLOGJIA – KAMPION PËRFAQËSUES I ZONAVE URBANE

Mbulimi i Kampionit	Zonat Urbane – Shqipëri
- Madhësia e Kampionit	N=600 familje
- Mosha e përzgjedhur	18+ vjeç
- Metoda	Përzgjedhje rastësore
- Mënyra e intervistimit	Ballë për ballë
- Toleranca e gabimit	±4.0%

IDRA përdor një kampionim me tre hapa për të arritur përfaqësinë urbane:

- (i) Hapi i parë përbën zgjedhjen e njësive primare të kampionit (*Primary Sampling Unit*), në rastin tonë, një numër qendrash votimi urbane për çdo qark të cilat përzgjidhen nga lista e qendrave të votimit të bëra publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Zona gjeografike që përfaqësohet nga qendra e votimit përbën njësinë primare të kampionimit.
- (ii) Hapi i dytë përbën zgjedhjen e shtëpive/familjeve. Përzgjedhja e shtëpive kryhet nëpërmjet metodës së ecjes rastësore. Intervistuesi shkon tek qendra e votimit¹, i kthen shpinën hyrjes së ndërtesës të qendrës, dhe duke mbajtur gjithmonë anën e djathtë fillon numëron banesë. Intervistuesi troket në çdo derë të tretë të cilën numëron.
- (iii) Hapi i tretë përbën zgjedhjen e respondentit. Përzgjedhja e respondentit bëhet nëpërmjet metodës së ditëlindjes së fundit. Intervistuesi merr listën dhe ditëlindjet e banuesve të shtëpisë të cilët janë të moshës 18 vjeç e sipër. Kontaktohet për intervistë banuesi i shtëpisë i/e cili/a ka festuar ditëlindjen i/e fundit nga dita e intervistës.

PROFIL I SHKURTËR I KOMPANISË IDRA RESEARCH & CONSULTING

IDRA Research & Consulting është një kompani që ofron shumëllojshmeri në shërbimet e hulumtimit të tregut dhe opinionit publik, e pranishme me zyra në Tiranë dhe Prishtinë. Kompania IDRA ka më shumë se 11 vite përvojë në kryerjen e hulumtimeve dhe ofrimin e këshillimit për kompani ose institucione të huaja dhe vendase. Klientë të IDRA janë institucionet më prestigjioze dhe serioze kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe shumë kompani biznesi me peshë në vend e më gjerë. Për më shumë informacion vizitoni faqen tonë www.idra.al.

¹ Qendrat e votimit janë përgjithësisht shkolla publike ose kopështe.